



**Prishtinë, 26.12.2019**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_1210\_2019**

**Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji,**

Bazuar në:

- Dispozitat e nenit 8, paragrafët 1 dhe 6, të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081;
- Dispozitat e nenit 15 dhe nenit 26 paragrafi 1, të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084; dhe
- Kërkesën e N.P. "Termokos" Sh.A., te datës 8 Nëntor 2019, për miratimin e dokumentit: Bilanci Vjetor i Energjisë Termike.

Pas shqyrtimit të dokumentit në fjalë dhe duke u bazuar në dispozitat ligjore të cekura më lartë, në seancën e mbajtur me datë **26.12.2019**, nxori këtë:

## **VENDIM**

### **I. APROVOHET BILANCI VJETOR I ENERGISË TERMIKE për vitin 2020 i NP "Termokos" Sh.A.**

#### **Arsyetim**

1. Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) ka pranuar draftin final të dokumentit: Bilanci Vjetor i Energjisë Termike për vitin 2020 nga NP "Termokos" Sh.A. si bartës i Licencës për operimin e sistemit të shpërndarjes së energjisë termike.
2. Pas shqyrtimit të draft-dokumentit "Bilanci Vjetor i Energjisë Termike" të dorëzuar nga NP "Termokos" Sh.A. dhe përmirësimit e plotësimit të tij sipas komenteve të ZRRE-së, Bordi i ZRRE - së duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- II. Obligohet i licencuari që pas pranimit të këtij Vendimi menjëherë të publikojë dokumentin "Bilanci Vjetor i Energjisë Termike - 2020" në faqen elektronike zyrtare të tij.
- III. Duke pasur parasysh ndikimin e parametrave të ndryshëm të bilancit në përcaktimin e tarifave, ZRRE mban të drejtën që gjatë shqyrtimit tariforë të përshtatë të dhënat që përmban Bilanci vjetor i energjisë termike.
- IV. Në zbatim të nenit 42, paragrafi 2.3 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë Nr. 05/L-084, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) do të monitoroj implementimin e Bilancit Vjetor të Energjisë Termike për të verifikuar realizimin e të dhënave dhe informatave të paraqitura në këtë Bilanc.



- V. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes midis versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së.
- VII. Ky Vendim publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së, ku gjithashtu do të publikohet edhe Bilanci unik i energjisë elektrike dhe energjisë termike.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të Vendimit në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:



---

Arsim Janova, u.d. Kryesues



---

Besim Sejfiqaj, Anëtar



---

Izet Rukshiti, Anëtar



---

Selman Hoti, Anëtar

Vendimit i bashkëngjitet dokumenti:

Bilanci Vjetor i Energjisë Termike – 2020, NP “Termokos” Sh.A.

Vendimi ju dërgohet:

- Palës; dhe
- Arkivit të ZRRE-së